



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.129

5 shtator

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.786, datë 22.7.2009	Për ngritjen dhe organizimin e stacionit të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në tunelin Thirrë-Kalimash	6033
Vendim i KM nr.792, datë 22.7.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Tepelenë	6033
Vendim i KM nr.793, datë 22.7.2009	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Universiteti i Tiranës Qendrës së Studimeve Albanologjike, të palestrës sportive të UT-së	6034
Vendim i KM nr.794, datë 22.7.2009	Për hapjen e programit të ri të studimit, pranë shkollës së lartë universitare, private, “Aldent”, Tiranë	6040
Vendim i KM nr.795, datë 22.7.2009	Për hapjen e programit të ri të studimit, pranë shkollës së lartë universitare, private, “Kristal”, dhe hapjen e filialit në qytetin e Kukësit	6041
Vendim i KM nr.796, datë 22.7.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, “Master i nivelit të dytë”, pranë shkollës së lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”	6042
Vendim i KM nr.797, datë 22.7.2009	Për licencimin e kolegjeve profesionale, private, “Medicom”	6044
Vendim i KM nr.798, datë 22.7.2009	Për licencimin e kolegjit profesional privat “New Generation”	6045

Vendim i KM nr.801, datë 22.7.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2009, në ministritë dhe institucionet qendrore”, të ndryshuar	6046
Vendim i KM nr.802, datë 22.7.2009	Për hapjen e programit të përbashkët rajonal të studimit “Master në “Eu Business Law””, në fakultetin e Drejtësisë të universitetit të Tiranës	6047
Vendim i KM nr.803, datë 22.7.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në matematikë, në Fakultetin e Shkencave Teknike të universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës	6048
Vendim i KM nr.806, datë 22.7.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.646, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, të ndryshuar	6049
Vendim i KM nr.820, datë 29.7.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Rrëshen-Prosek	6049
Vendim i KM nr.821, datë 29.7.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës kombëtare në Sauk	6052
Vendim i KM nr.822, datë 29.7.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.207, datë 21.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i dytë)”	6054
Vendim i KM nr.823, datë 29.7.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.269, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i parë)”	6061
Kërkesë e MPPTT nr.4132/3, datë 3.8.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Krum-Golaj”	6067

VENDIM
Nr.786, datë 22.7.2009

PËR NGRITJEN DHE ORGANIZIMIN E STACIONIT TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI NË TUNELIN THIRRË-KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tunelin Thirrë-Kalimash, në anën, që lidhet me qytetin e Kukësit, të ngrihet stacioni i policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si pjesë e sistemit të Drejtorisë së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMNZSH).

2. Emërimi, titullimi, transferimi dhe lirimi nga detyra e oficerit të stacionit të PMNZSH-së në këtë objekt të bëhen nga Ministri i Brendshëm.

3. Plotësimi me personel shërbimi i këtij stacioni të bëhet nga prefekti i qarkut, me propozimin e shefit të stacionit të PMNZSH-së së objektit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” dhe me aktet e tjera nënligjore, dalë në zbatim të tij.

4. Organizimi, drejtimi dhe formimi profesional i personelit të këtij stacioni të bëhen nga shefi i PMNZSH-së së objektit dhe të kontrollohen nga drejtorja e PMNZSH-së.

5. Efekti financiar për ngritjen dhe funksionimin e stacionit të PMNZSH-së, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi arrin vlerën 10 612 000 (dhjetë milionë e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë, për shpenzime personeli.

6. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

7. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.792, datë 22.7.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN-TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Levantepelenë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Bashkëpronarët, e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të shpronësohen për pasurinë e paluajtshme, objekti “Poligon”, Memaliaj, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 8 005 031

(tetë milionë e pesë mijë e tridhjetë e një) lekë, në vlerën përkatëse, sipas pjesës së regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tepelenë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 8 005 031 (tetë milionë e pesë mijë e tridhjetë e një) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë më 30.7.2009 dhe të përfundojë më 30.10.2009.

6. Bashkëpronarët e objektit “Poligon”, Memaliaj, të kompensohen, për efekt shpronësimi, sipas pjesëve përkatëse, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e bashkëpronarëve, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të paraqitet prej tyre, si dhe në bazë të konfirmimit, që do të kërkohet nga kjo drejtori pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tepelenë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr.	Pronari	Nr. pas sipas regjistrimit hipotekor	Vendndodhja	Objekt Vlera lekë	Shënime Pjesët e regjistruara sipas konfirmimit të ZRPP-së Tepelenë
	Emri, mbiemri				
1	Shpresa Shehu	3260	Memaliaj	8 005 031	25/35
2	Violeta Zhupa	“	“		1/35
3	Violeta Zota	“	“		1/35
4	Behare Hoxha	“	“		1/35
5	Sinan Alimema	“	“		1/35
6	Hateme Pasha	“	“		1/35
7	Elisabeta Muci	“	“		1/35
8	Fatmira Sulka	“	“		1/35
9	Thalie Dushi	“	“		1/35
10	Durime Sulka	“	“		1/35
11	Elisabeta Malka	“	“		1/35
	TOTALI			8 005 031	

VENDIM
Nr.793, datë 22.7.2009

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA UNIVERSITETI I TIRANËS QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TË PALESTRËS SPORTIVE TË UT-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Universiteti i Tiranës Qendrës së Studimeve Albanologjike, të objektit “Palestër sportive” të Universitetit të Tiranës (UT), së bashku me mjediset e tjera ndihmëse, truallin e ndërtesës dhe oborrin e rrethuar, sipas genplanit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Objekti i mësipërm, pas kryerjes së rehabilitimit dhe përshtatjes, të përdoret në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Qendrës së Studimeve Albanologjike.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

n: Pushteti Qendror: QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE Kopuna: TIRANE Identifikator: Arben Djalila / Financier Supervisor: Arben Djalila / Financier Aprobimi: Arben Djalila / Financier Jendormit le Prones: Arben Djalila / Financier										
A			B							
Zona Kadastre & Indeksi Hartes	Nr. Pasurise	Lloji Prones	Emri/Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin periodat Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shkrimet le vecantia)	
2.	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
			Godina e Q.S.A dhe Muzeut Arkeologjik - Tirane Sheshi "Nene Tereza" TIRANE.	8.904	8.904	Zgryra Muze Fonde.	QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJ ALBANOLOGJ	QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJ		
			Palatira i Zgryra Dergest. E d. Fyrik Ullas mulla e bushetllit i dhona qendrore	1240	543		Q.S.A.	Q.S.A.		

GENPLANI I FUSHES SE BASKETBOLLIT DHE AMBJENTEVE TE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES

SH 1:500


Sip. Ndertimi DHOMAT 121.50m² SIP. NDERTIMIT 193.20m²
Sip. Ndertimi ZYRAT 71.70m² SIP. TRUALLIT 710.58 m²
Sip. Truali FUSHA 517.38m²



**GENPLANI I FUSHES SE BASKETBOLLIT DHE AMBJENTEVE
TE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES**

SH 1:500

Sip. Ndertimi DHOMAT 121.50m² SIP. NDERTIMIT 193.20m
Sip. Ndertimi ZYRAT 71.70m² SIP. TRUALLIT 710.58 m²
Sip. Truallit FUSHA 517.38m²



PLAN RILEVIMI

PERGATITI Studio Ligjore "Gimaj" Savet Allaj Licencë Nr. TZ 0457 Date :2003 Data e pergatitjes 29/05/2009 Nipit K 71704001 W Vale-Firme	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8160 NR. I PASURISE 710 - 7092 INDEKSI I HARTES TR-S-12 SHKALLA 1:500 ADRESA E PASURISE: Rrethi Tiranë QF. TIRANË Rr. " SHESHI NEN TEREZA " P/G Sh. K. Ap. PRONARI: QENDRA STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE (INSTRUMETI ARKEOLOGJIKE)
--	--


Sip. Nderlimi DHOMAT 121.50m²
Sip. Nderlimi ZYRAT 71.70m²
Sip. Truallit FUSHA 517.38m²

SIP. TOTAL E NDERTIMIT = 193.20 m²
SIP. TOTAL E TRUALLIT = 710.58 m²

GENPLANI I FUSHES SE BASKETBOLLIT DHE AMBJENTEVE TEKNIKE

Sip. Nderlimi DHOMAT 121.50m² SH 1:250
Sip. Nderlimi ZYRAT 71.70m² SIP. NDERTIMIT 193.20m²
Sip. Truallit FUSHA 517.38m² SIP. TRUALLIT 710.58 m²

Veriu: Nr. Pasurise 7/2 (Lulishte Pallati "Kongreseve")
Lindje: Nr. Pasurise 7/15
Jugu: Nr. Pasurise 7/9/3 (Q. S. A.)
Perendimi: Nr. Pasurise 7/9/2, 7/9/3 (Q. S. A.)
Pronari : MINISTRIA E ARSIMIT
V.O. Ky rilevim eshte hartuar duke ju referuar faktit
dhe hartes kadastrale te Z.R.P.P TIRANE




GENPLANI I PALESTRES SE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES

SH 1:500

SIP. NDERTIMIT 354.03m²

SIP. TRUALLIT 519.50 m²



VENDIM
Nr.794, datë 22.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE, PRIVATE, “ALDENT”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 40, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, në “Infermieri e përgjithshme”, në formën e studimeve me kohë të plotë, pranë shkollës së lartë universitare, private, “Aldent”, Tiranë.
 2. Kohëzgjatja normale e programit të studimit të ciklit të parë të jetë 3 (tri) vite akademike, me plotësimin, së paku, të 180 krediteve. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP) në “Infermieri e përgjithshme”.
 3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private, “Aldent”, që, për këtë program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimet e nevojshme.
 4. Shkolla e lartë universitare, private, “Aldent”, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
 - Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.
 5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
 6. Shkolla e lartë universitare, private, “Aldent”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
 7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.795, datë 22.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE, PRIVATE “KRISTAL” DHE HAPJEN E FILIALIT NË QYTETIN E
KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, në “Mësuesi për arsimin fillor”, në formën e studimeve me kohë të plotë, pranë shkollës së lartë universitare, private, “Kristal”, Tiranë.

2. Kohëzgjatja normale e programit të studimit, të ciklit të parë, të jetë 3 (tri) vite akademike, me plotësimin, së paku, të 180 krediteve. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP) në “Mësuesi për arsim fillor”.

3. Hapjen e të njëjtit program studimi, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Mësuesi për arsimin fillor”, në filialet e qytetit të Fierit dhe të qytetit të Korçës.

4. Hapjen në qytetin e Kukësit, të filialit të këtij universiteti, të Fakulteteve të Drejtësisë, të Shkencave Politike, të Infermierisë dhe të Administrim-biznesit, si pjesë përbërëse e shkollës së lartë universitare, private, “Kristal”, Tiranë.

5. Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në filialin e Kukësit, në:

- a) Drejtësi;
- b) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- c) Shkenca komunikimi;
- ç) Psikologji;
- d) Infermieri;
- dh) Menaxhim biznesi;
- d) Financë.

6. Programet e studimit, të përcaktuara në pikat 3 e 5 të këtij vendimi, të jenë të njëta me programet e studimit, që shkolla e lartë universitare, private, “Kristal”, ofron në selinë qendrore të saj në Tiranë. Ato do të realizohen me 18 kredite dhe kohëzgjatja e tyre do të jetë 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), përkatësisht në:

- a) Drejtësi;
- b) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- c) Shkenca komunikimi;
- ç) Psikologji;
- d) Infermieri;
- dh) Menaxhim biznesi;
- d) Financë.

7. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private, “Kristal”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

8. Shkolla e lartë universitare, private, “Kristal”, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në këtë vendim, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

9. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Shkolla e lartë universitare, private, “Kristal”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional të këtyre programeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

11. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.796, datë 22.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, “MASTER I NIVELIT TË DYTË”,
PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE, “UNIVERSITETI EVROPIAN I
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të dytë”, pranë shkollës së lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, në:

a) “Ekonomi dhe zhvillim i qëndrueshëm”, me profile:

- i) Administrata dhe politikat publike;
- ii) Urbanizimi, zhvillimi territorial dhe politikat mjedisore;
- iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- iv) E drejtë ekonomike.

b) “Financë”, me profile:

- i) Financat publike;
- ii) Qeverisja e korporatave;
- iii) Tregjet financiare dhe menaxhimi bankar;
- iv) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare.

c) “Menaxhim”, me profile:

- i) Liderhipi dhe menaxhimi i karrierës;
- ii) Biznes dhe marketing ndërkombëtar;
- iii) Komunikimi në biznes;
- iv) E drejtë ekonomike.

ç) “Sociologji”, me profile:

- i) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- ii) Kriminalogji;
- iii) Globalizimi dhe zhvillimi;
- iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.

d) “Shkenca komunikimi”, me profile:

- i) Komunikimi dhe sjelljet politike;
- ii) Komunikimi në biznes;
- iii) Liderhipi dhe menaxhimi i karrierës;
- iv) Teori dhe modele komunikimi.

dh) “Shkenca politike”, me profile:

- i) Globalizimi dhe zhvillimi;
- ii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- iii) Administrata dhe politikat publike;
- iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.

e) “Marrëdhëniet ndërkombëtare”, me profile:

- i) Globalizimi dhe zhvillimi;

- ii) Studime të sigurisë dhe gjeopolitikës;
- iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- iv) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare.
- ë) E drejtë publike, me profile:
 - i) E drejtë kushtetuese dhe administrative;
 - ii) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare;
 - iii) Kriminologji;
 - iv) E drejtë penale.
- f) “E drejtë private”, me profile:
 - i) E drejtë ekonomike;
 - ii) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare;
 - iii) E drejtë civile;
 - iv) Qeverisja e korporatës.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” (MND) të jenë programe studimi të ciklit të tretë, me, të paktën, 60 kredite. Në mbarim të programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në:

- a) “Ekonomi dhe zhvillim i qëndrueshëm”, me profile:
 - i) Administrata dhe politikat publike;
 - ii) Urbanizimi, zhvillimi territorial dhe politikat mjedisore;
 - iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
 - iv) E drejtë ekonomike.
- b) “Financë”, me profile:
 - i) Financat publike;
 - ii) Qeverisja e korporatave;
 - iii) Tregjet financiare dhe menaxhimi bankar;
 - iv) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare.
- c) “Menaxhim”, me profile:
 - i) Liderhipi dhe menaxhimi i karrierës;
 - ii) Biznes dhe marketing ndërkombëtar;
 - iii) Komunikimi në biznes;
 - iv) E drejtë ekonomike.
- ç) “Sociologji”, me profile:
 - i) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
 - ii) Kriminologji;
 - iii) Globalizimi dhe zhvillimi;
 - iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.
- d) “Shkenca komunikimi”, me profile:
 - i) Komunikimi dhe sjelljet politike;
 - ii) Komunikimi në biznes;
 - iii) Liderhipi dhe menaxhimi i karrierës;
 - iv) Teori dhe modele komunikimi.
- dh) “Shkenca politike”, me profile:
 - i) Globalizimi dhe zhvillimi;
 - ii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
 - iii) Administrata dhe politikat publike;
 - iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.
- e) “Marrëdhëniet ndërkombëtare”, me profile:
 - i) Globalizimi dhe zhvillimi;
 - ii) Studime të sigurisë dhe gjeopolitikës;
 - iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
 - iv) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare.
- ë) “E drejtë publike”, me profile:
 - i) E drejtë kushtetuese dhe administrative;
 - ii) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare;
 - iii) Kriminologji;

- iv) E drejtë penale.
- f) “E drejtë private”, me profile:
- i) E drejtë ekonomike;
- ii) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare;
- iii) E drejtë civile;
- iv) Qeverisja e korporatës.

3. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

4. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, pas marrjes së lejes përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës strukturohet si universitet.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.797, datë 22.7.2009**

PËR LICENCIMIN E KOLEGJEVE PROFESIONALE, PRIVATE, “MEDICOM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 7, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e kolegjeve profesionale, private, “Medicom”, që do të ushtrojnë veprimtarinë në qytetin e Tiranës, të Fierit, Elbasanit, Korçës dhe Shkodrës.

2. Secili kolegji profesional, privat, “Medicom”, do t’i ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në “Infermieri e përgjithshme” dhe “Teknikë laborator”, në formën e studimit me kohë të plotë, të cilat do të zgjasin 3 (tri) vite akademike. Në mbarim të studimeve lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), përkatësisht në:

- a) Infermieri e përgjithshme;
- b) Teknikë laborator.

3. Ngarkohen kolegjet profesionale, private, “Medicom”, që, për programet e studimit, të sigurojnë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Kolegjet profesionale, private, “Medicom”, ta fillojnë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të kenë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Kolegjet profesionale, private, “Medicom”, duhet t’i nënshtrohen procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.798, datë 22.7.2009

PËR LICENCIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL, PRIVAT, “NEW GENERATION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 7, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e kolegjit profesional, privat, “New Generation”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji profesional, privat, “New Generation”, do të ofrojë programin e studimit, të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të plotë, në “Masazheri estetikokuruese” i cili do të zgjasë 3 (tri) vite akademike.

Në mbarim të studimeve lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP) në “Masazheri estetikokuruese”.

3. Ngarkohet kolegji profesional, privat, “New Generation”, që, për programin e studimit, të sigurojnë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Kolegji profesional, privat, “New Generation”, ta fillojnë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të kenë marrë, jo më vonë se tre javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Kolegji profesional, privat, “New Generation”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.801, datë 22.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1694, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2009, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i përgjithshëm i punonjësve buxhetorë, për vitin 2009, për ministrinë dhe institucionet qendrore, bëhet “89 881 veta”, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	Viti 2009
3	Kryeministria	128
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:	774
	- Drejtoria e Standardeve	18
	- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	135
	- Drejtoria e Metereologjisë e Kalibrimit	110
	- Qendra Kombëtare e Licencimit	35
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nga e cila:	2198
	- Bordet e kullimit	650
	- Agjencia e Pagesave	86
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1360
10	Ministria e Financave, nga e cila:	3203
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1062
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1616
	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	26
	- Agjencia e Lojërave të Fatit	25
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	39231
	Parauniversitar	38241
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1103
13	Ministria e Shëndetësisë	3530
14	Ministria e Drejtësisë, nga e cila:	5026
	- Avokati i Shtetit	55
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	550
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150
	- Shërbimi i Provës	50
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188
	Ambasadat dhe përfaqësitë	428
16	Ministria e Brendshme, nga e cila:	13305
	- Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11791

18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	31
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	14134
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1399
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25
78	Ministria e Integritetit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare, nga të cilat:	103
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	38
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20
	Total numri i punonjësve	86 706
	Numri i punonjësve në institucionet e pavarura	3 175
	Total, numri i punonjësve buxhetorë	89 881

VENDIM
Nr.802, datë 22.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT RAJONAL TË STUDIMIT “MASTER NË
“EU BUSINESS LAW””, NË FAKULTETIN E DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT TË
TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, të programit të përbashkët rajonal të studimit “Master në “EU Business Law”” (Master në të Drejtën e Biznesit të BE-së), i cili, sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, do të zhvillohet edhe në disa vende të rajonit.

2. Programi i studimit do të jetë pjesë e studimeve të ciklit të dytë (i përkon nivelit 7, në KEK). Ai do të organizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale një vit, përfshirë edhe mikrotezën, dhe në përfundim të studimeve lëshohet një diplomë “Master në “EU Business Law””.

3. Në këtë program studimi do të pranohen kandidatët, që kanë fituar diplomë në përfundim të një programi studimi, të ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 4 vjet, me 240 kredite, sipas sistemit të Bolonjës, ose që zotërojnë një diplomë tjetër, ekuivalente me të, të kryer jashtë vendit.

Gjithashtu, në këtë program studimi mund të pranohen edhe kandidatët, që zotërojnë diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë ose diplomë tjetër, të fituar jashtë vendit, ekuivalente me to, të cilët kërkojnë të kualifikohen në këtë drejtim.

4. Studentët, të cilët e përftojnë këtë diplomë, kanë të drejtë të regjistrohen në programe studimi të ciklit të tretë. Ata nuk mund t’i transferojnë kreditet e fituara në këtë program studimi në një program studimi të ciklit të tretë.

5. Kuotat e pranimit në këtë program studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, do të jenë 40 studentë.

6. Tarifa e shkollimit do të jetë 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.803, datë 22.7.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË MATEMATIKË, NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” TË
VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në matematikë, në Fakultetin e Shkencave Teknike të universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor”.

2. Kohëzgjatja normale e programit të studimeve të doktoratës në matematikë është, të paktën, 3 (tri) vite dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

3. Kuotat e pranimi në këtë program studimi, për vitin 2009, janë gjithsej 25, prej të cilave 10 për kandidatë nga jashtë kufijve të vendit.

4. Tarifa e plotë e shkollimit për këtë program studimesh është 400 000 (katërqind mijë) lekë dhe likuidohet me këste, sipas përcaktimeve të bëra nga fakulteti përkatës, për çdo vit të kohëzgjatjes normale. Doktorantët, nga stafi akademik i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë, paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.806, datë 22.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.646, DATË 30.9.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.646, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Numri limit i punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në qarqe, të jetë, gjithsej, 739 veta.”.

2. Në lidhjen nr.3, të përmendur në pikën 2, në sektorin e PMNZSH-së, së qarkut Kukës, të shtohet stacioni i policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në tunelin Thirrë-Kalimash, me këtë përbërje:

“Stacioni i policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në tunelin Thirrë-Kalimash

- Shefi i PMNZSH-së, për objektin, oficer, 1 (një);
- Komandant stacioni, oficer, 1 (një);
- Komandant turni, polic, 4 (katër);
- Shofer zjarrfikës, polic, 17 (shtatëmbëdhjetë);
- Zjarrfikës/shpëtues, polic, 27 (njëzet e shtatë).”.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.820 datë 29.7.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS RRËSHEN-PROSEK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Rrëshen-Prosek.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

